



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
REKTORATI

Nr. 359 prot

Durrës, më 19.3 .2021

V E N D I M

Nr. 6 , datë 19.3 .2021.

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 685 datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Statutit të Universitetit, të Rregullores së Universitetit, Rektorati

V E N D O S I :

1. Ngarkimin e dekanëve të fakulteteve, Drejtorisë së Burimeve Njerzore në marrje e masave për hartimin e kontratave për lektorët të cilët do të angazhohen si personel akademik me kohë të pjesshme për semestrin e dytë viti akademik 2020-2021 për ciklin e parë dhe të dytë të studimeve. Bazuar në shkresat e fakulteteve bashkëngjitur.
 - ✓ Shkresa me Nr. 145 prot., datë 12.03.2021 nga Dekani i Fakultetit të Studimeve Profesionale
 - ✓ Shkresa me Nr. 59 prot., datë 11.03.2021 dhe Shkresa me Nr. 61 prot., datë 12.03.2021 nga Dekani i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit
 - ✓ Shkresa me Nr. 469 prot., datë 12.03.2021 nga Dekani i Fakultetit të Edukimit,
 - ✓ Shkresa me Nr. 117 prot., datë 16.03.2021 nga Dekani i Fakultetit të Shkencave Politike Juridike
 - ✓ Shkresa me Nr. 248 prot., datë 12.03.2021 dhe Shkresa me Nr. 241 prot, datë 12.03.2021 i Dekanit të Fakultetit të Biznesit.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi
 - Zv.Rektorët
 - Administratori
 - Dekanët e Fakulteteve
 - Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Juridike
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Prof.Dr. Ksanela SOTIROFSKI